

III TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT DHE QYTETARIT

NOCIONET KRYESORE:

Teoria e të drejtës natyrore; teoria e të drejtës pozitive; të drejtat personale; të drejtat politike; të drejtat sociale; të drejtat kulturore; të drejtat ekonomike; detyrat; Gjyqi i të drejtave të njeriut.

PYETJE:

1. Cilat janë dokumentet(aktet) më të rëndësishme për të drejtat dhe liritë?
2. Çka parasheh Deklarata universale për të drejtat e njeriut nga viti 1948 ?
3. Numëroni disa të drejta personale ?
4. Numëroni disa të drejta politike ?
5. Numëroni disa të drejta ekonomike ?
6. Numëroni disa të drejta sociale ?
7. Numëroni disa të drejta kulturore ?
8. A mund shtetasit të RM t'i merret shtetësia ?
9. A mund shtetasi i RM të jetë i larguar nga vendi ?
10. Në cilën shkallë të arsimit mund të formohen institute arsimore private ?
11. Çka është pronësi intelektuale dhe industriale ?
12. Çka është shtet laik dhe a mund RM të vihet në atë term ?
13. Çka është prezumpcioni i pafajsisë ?
14. Paraqitni disa detyra ?
15. Kundër kujt është i drejtuar peticioni para Gjyqit për të drejtat e njeriut?
16. Çfarë kompensimesh mund të përcaktojë Gjyqi për të drejtat e njeriut në rast se vërteton shkelje të ndonjë të drejte ?

Të drejtat dhe liritë janë kriter dhe masë themelore për pozitën dhe rolin e njeriut dhe qytetarit në shoqëri, nga njëra anë dhe demokratizimi i regjimit (sistemit), nga ana tjetër. Ato janë instrument për kufizimin e pushtetit dhe pengimin e arbitrazhës dhe keqpërdorjes së saj.

Pse flasim për *liritë themelore* ? Sepse dalin nga vetë natyra e njeriut, ndërsa jo nga vullneti i pushtetit shtetëror.” Njerëzit lindin të barabartë dhe të lirë”, tha Ruso, ndërsa e vërtetoi edhe Deklarata për pavarësi e SHBA nga viti 1776.

Të drejtat janë akt i shkallës së caktuar të zhvillimit të civilizimit, fryt i kuptimit të ri të botës dhe jetës.

Dimenzioni teorik i të drejtave dhe lirive është ngushtë i lidhur me teorinë për të drejtën natyrore, me dukurin e kushtetutës si dokument i shkruar dhe me ndërtimin e rregullimit të vetëm ndërkombëtar.

1. Konceptet për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit

1.1. Teoria për të drejtën natyrore

Rrënjët e teorisë të së drejtës natyrore i gjejmë në mendimet filozofike të stoikëve dhe sofistëve. Për sofistët, njerëzit sipas natyrës janë të barabartë, ndërsa robëria është gjendje jonatyrore. Sipas stoikëve, njerëzit sipas natyrës janë të pajisur me mençuri(logos) dhe ato proporcionalisht duhet të marrin pjesë në jetën publike, me ato lidhet edhe mendimi romak. Për Ciceronin e drejta natyrore është mendje e drejtë(*recta ratio*) në pajtim me natyrën.

Teoria për të drejtën natyrore e shekullit XVII dhe XVIII do të përfaqësohej nga Xhon Loku dhe Tomas Xhefersoni. Për të dy, njerëzit sipas natyrës janë të lirë dhe të barabartë dhe posedojnë të drejta të patjetërsueshme dhe të paprekshme, të cilat pushteti shtetëror mund vetëm t'i mbrojnë, por jo edhe t'i kufizojë dhe anulojë.

Teoria për të drejtën natyrore i lidh të drejtat dhe liritë me drejtësinë si vlerë.

1.2. Teoria për të drejtën pozitive

Teoria për të drejtën pozitive në të drejtat dhe liritë i sheh si prodhim të pushtetit sovran shtetëror. Ato janë kreacion i pushtetit shtetëror. Ai mund t'i kufizojë ose t'i anulojë, e udhëhequr nga rezoni shtetëror. Domethënë të drejtat dhe liritë nuk janë veti njerëzore natyrore, por kategori e rregullimit shtetëror. Njeriu nuk është qytetar, por prodan. Të drejtat dhe liritë nuk janë në funksion të drejtsisë dhe të vërtetës, por në funksion të pushtetit shtetëror.

2. Dokumentat për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit

Ideja për të drejtat dhe liritë e njeriut ka lindur në Greqinë e vjetër, Romën e vjetër dhe në Mesjetë. Në polisët greke, qytetarët kanë pasur të drejtë të flasin (isigoriya) si edhe barazia përpara ligjit (isynomija). E njëjta vlen edhe për qytetarët romak, e ndërsa Mesjeta është e njohur me numrin e madh të konventave për privilegje të gupeve dhe etazheve të caktuara. Por, edhe Greqia e vjetër edhe Roma e vjetër edhe Mesjeta janë kohë e robërisë dhe e frymës kolektive. Greqia e vjetër mbetet bazë e demokracisë, Roma e vjetër burim i së drejtës, ndërsa Mesjeta kohë e Konventave të rëndësishme.

Konventa e madhe e lirive (Magna Carta Libertatum) nga viti 1215 në disa dispozita ende është dokument i vlefshëm në të drejtën anglosaksone me të cilën feudalët anglez kanë fituar privilegje të caktuara për vete nga mbreti Jovan Bezzemja. Në nenin 40, thuhet : “ E drejta dhe drejtësia askujt nuk do t’ju jepen, shkurtohen ose anulohen”.

Në shekullin XVII në Angli do të silltet Peticioni për të drejtat (Petitioni of Rights) nga viti 1628, Bili i të drejtave (Bill of Rights) nga viti 1689 dhe veçanërisht i njohuri Habeas Corpus Act (1679), si bazë dhe inspirim i të gjithë dokumentave të ardhshëm të karakterit të tillë. Me atë, potencohet se askush nuk mund të burgoset pa autorizim, as edhe të mbyllet pa aktgjykim të përkatëshëm gjygjësor, ndërsa e drejta e jëtës, liria dhe pronësia mbetën të drejta pozitive.

Pasojnë dy deklarata veçanërisht të rëndësishme. Deklarata për pavarësi e SHBA nga viti 1776 me të cilat 13 koloni britanike u përshëndetën me mbretin britanik duke u bazuar në të drejtat politike të popullit dhe duke i elaboruar arsyet për largimin nga robëria koloniale.

Billi i të drejtave nga viti 1776, është dokument i parë i sistematizuar për të drejtat e njeriut, të proklamuar në vitin 1776 në shtetin e Virgjinisë. Me të janë të shpallura ‘ të drejtat dhe liritë e individit’ si hyrje te Kushtetuta e Virxhinisë.

Megjithatë, Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit nga 26.08.1789 është platëformë dhe program ideo-politike i lëvizjeve më të njohura revolucionare.

Neni 1 nga kjo Deklaratë thotë : “Njerëzit lindin dhe jetojnë të lirë dhe të barabartë në të drejtat”.

Liria është në mundësinë të mos i bëhet dëm tjetrit. Ashtu që, posedimi i të drejtave natyrore të secilit njeriu nuk ka kufij, përveç atyre të cilëve edhe anëtarët e tjerë të shoqërisë u mundësojnë posedimin e të drejtave të njejta.

Xhon Loku (1632-1704), filozof-empirik anglez, në “ Dy shqyrtimet për pushtetin”(libri I, Kreu 2.4.) kështu i përcakton të drejtat natyrore të njeriut:

“ Gjendja e të gjithë njerëzve është gjendje e lirisë së përkryer t’i përcaktojnë aktivitetet e veta dhe të disponojnë me pronën e tyre dhe me personalitetin e tyre ashtu siç mendojnë se është adekuate në kufijtë e ligjit natyror, ndërsa për atë të mos kërkojnë leje nga asnjë njeri tjetër ose të varen nga vullneti i tyre.

Gjithashtu, ajo është gjendje e barazisë në të cilën i gjithë pushteti dhe fuqia juridike janë reciproke, pasi që asnjë nuk ka më shumë fuqi nga tjetri, pasi që asgjë nuk është aq e qartë se lindja e të gjithë qenieve nga lloji dhe gjinia e njëjtë u ka sjell edhe vlera natyrore të njëjta dhe shfrytëzimi i aftësive të njëjta, atëherë të gjithë njerëzit e në mënyrë të njëjtë duhet të jenë të ndërsjelltë.....edhe pse kjo është gjendje e lirisë, megjithatë nuk është gjendje e autokracisë...asnjëri nuk duhet të bëjë dëm në jetën, shëndetin, lirinë ose pronën e huaj...”

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, në të cilën dolën në shesh ambicjet për diskriminim dhe zhdukjen e njerëzve , në vitin 1945 është formuar OKB-ja për të ndërtuar paqën dhe të kuptuarit e popujve, si edhe marrëveshjet të krijuara për respektimin e të drejtave të njeriut. Kuvendi i përgjithshëm miratoi Deklaratën universale për të drejtat e njeriut si standard i përgjithshëm i të gjithë njerëzve dhe kombeve në vitin 1948 (Universal declaration of Human Rights). Është e përbërë nga hyrja dhe 30 nene.

Neni 1 – Të gjithë qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitetin dhe të drejtat. Ato janë të pajisur me intelekt dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen njëri ndaj tjetërit në frymën e përkatësisë gjithënjëzore.

Me këtë akt liritë dhe të drejtat e njeriut bëhen problematikë ndërkombëtare bazë për ndërtimin e vetëm të rregullimit ndërkombëtar, ndërsa jo vetëm për çështje të së drejtës së brendëshme.

OKB solli edhe dokumente të tjera nga sfera e të drejtave të njeriut, midis të cilëve edhe Paktin ndërkombëtar të të drejtave qytetare dhe politike dhe Paktin ndërkombëtar të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore nga viti 1966.

Të gjitha këto akte ndërkombëtre si edhe konvencat e tjera për liritë dhe të drejtat e njeriut, kanë karakter të normave ndërkombëtare imperative (të domosdoshme) (ius cogens), pa dallim a janë të ratifikuara nga ndonjë shtet.

Bashkësia ndërkombëtare nuk kënaqet me vërtetimin e standardeve në sferën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ajo bënë edhe kontrollin ndaj respektimit dhe realizimit të lirive dhe të drejtave në praktikën nëpërmjet mekanizmave të vëzhgimit (monitoringu) dhe mund të japë edhe sanksione të caktuara kundër shteteve të caktuara kur disponon me të dhëna për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Megjithatë, OKB ende nuk ka arritur të vë mekanizëm institucional për mbrojtje konkrete të të drejtave dhe lirive të njeriut. Këshilli i Evropës veç më

etabloun instrument të tillë me Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga viti 1991 : Komisioni Evropian dhe Gjyqi Evropian për të drejtat e njeriut (neni 19). Në mënyrë të qartë shihet se element bazë në ndërtimin e arkitekturës ndërkombëtare bëhen të drejtat dhe liritë e njeriut.

3. Të drejtat dhe liritë në Republikën e Maqedonisë

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të qytetarëve janë materie kushtetuese në Republikën e Maqedonisë. Së pari, të drejtat dhe liritë e njeriut janë të treguara me qëllim që kushtetutëdhënësi, Kuvendi, e sjell Kushtetutën (preambula e Kushtetutës së 1991). Pastaj, të drejtat dhe liritë e njeriut janë vlerë themelore e rregullimit kushtetues në RM (neni 8, alineja 1). Së fundi, një kapitull i tërë i është dedikuar Të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarëve. Në frymën e traditës liberalo- demokratike, Kushtetuta e RM vend qëndror u jep lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarëve, duke përvetësuar nga lista e gjerë e cila zë thuajse një të tretën nga numëri i përgjithshëm i neneve të Kushtetutës.

Esenca e të drejtave dhe lirive të qytetarit është e drejta dhe liritë personale dhe me ato fillon lista e gjatë të cilës i paraprinë parimi i jodiskriminimit të qytetarëve nga cila do bazë: gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, nacionaliteti, përkatësia sociale, përkatësia fetare dhe politike, pozita pronësore dhe shoqërore.

Duke e pasur parasysh dimensionin historik, të drejtat dhe liritë personale janë të drejtat dhe liritë më të vjetra dhe lufta për kushtetutëshmëri fillon me betejën për të drejtën e jetës, të drejtën e lirisë, të drejtën e pronës, të drejtën e fatit, liria e ndërgjegjes, ndërsa kundër absolutizmit dhe despotizmit. Ato e shprehin dhe mbrojnë integritetin fizik dhe shpirtëror të njeriut, gjegjësisht janë edhe supozim edhe kusht për realizimin e të drejtave dhe lirive të tjera, veçanërisht të atyre politike.

Kushtetuta e RM e zgjeron listën standarde të të drejtave dhe lirive me: Lirinë e të menduarit, lirinë e të besuarit, lirinë e lëvizjes dhe vendosjen, të drejtën e lirisë, të drejtën private dhe të drejtën e shtetësisë.

Me heqjen e dënimit me vdekje (neni 10), Kushtetuta e RM hyri në familjen abolicionistike të botës, duke e lëshuar trendin e rregullimit paraprak kushtetues. Kuptohet, E drejta e jetës nuk do të thotë vetëm ekzistencë biologjike (botëkuptimi juridik), por edhe e drejtë e jetës së lumtur dhe humane (në kuptimin e Lokut dhe Xhefersonit).

Të cekim se përveç garantimit të *integritetit fizik dhe moral*, flitet edhe për shkelje të shpeshtë të sferës së të drejtave dhe lirive të njeriut në botë. Për këtë me argumente dhe në mënyrë piktoreske flasin raportet e Amnesty Internacional, Helsinki Watch ose raportit vjetor i të drejtave të njeriut i Stejt departamentit të SHBA.

Kushtetuta e RM, lirinë e njeriut e përcakton si të pacënueshme. *E drejta e lirisë* mund të jetë e kufizuar vetëm me vendim gjyqësor dhe në raste dhe në proces të vërtetuara me ligj. Kushtetuta më detajisht e rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe të drejtat që i ka personi që i është hequrë liria.

Prezumimi i pafajsisë (supozimi), gjithashtu, është një nga të drejtat të cilat janë të përfëshira me Kushtetutë. Ajo është garanci se personi që është i fajsuar për vepër penale do të vlerësohet si i pafajshëm derisa faji i tij nuk vërtetohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

E drejta e privatësisë është njëra nga të drejtat më të shkelura në mënyrën e jetesës së sotme bashkëkohore. Kushtetuta garanton respektimin dhe mbrojtjen e privatimit të jetës personale dhe familjare, të dinjitetit dhe ndërgjegjes; fshehtësinë dhe sigurimin e të dhënave personale.

Ngushtë e lidhur me të drejtën private është edhe e drejta e *fshehtësisë së letrave dhe formave të tjera të shprehjes*. Sipas vendimit të gjyqit mund të tërhiqemi nga parimi i pacënueshmërisë së fshehtësisë së letrave dhe të formave tjera të shprehurit,¹ nëse ajo është e domosdoshme për udhëheqjen e procedurës penale ose atë e kërkojnë interesat e mbrojtjes së Republikës.

Gjithashtu, me të drejtën private është e lidhur ngushtë edhe e drejta e paprekshmërisë së shtëpisë. Ajo mund të jetë e kufizuar vetëm me vendim të gjyqit kur është në pyetje çështje për zbulimin dhe pengimin e veprave penale ose mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Kushtetuta garanton edhe *lirinë e lëvizjes dhe vendosjes*. Secili qytetar i RM ka të drejtë lirisht të lëvizë në territorin e Republikës dhe lirisht të zgjedhë vendin e vendbanimit të tij. Secili qytetar ka të drejtë t'a lëshojë territorin e Republikës dhe të kthehet në Republikë. Por, Kushtetuta jep mundësi për kufizimin e realizimit edhe të këtyre të drejtave.

Liria e të menduarit, e ndërgjegjes dhe e besimit janë të drejta të rëndësishme të njeriut që lirisht të mendojë, lirisht të ndërtojë pikëpamje personale për botën. Ajo do të thotë, çlirimi i njeriut nga imponimet e ideologjive oficiale, dhe nga imponimi me dhunë i dogmave.

Liria e besimit, është e drejtë e njeriut që lirisht dhe publikisht, veçmas ose në bashkësi me të tjerët ta shprehë fenë. Kushtetuta garanton edhe barazi të bashkësive fetare dhe grupeve religjioze dhe shteteve të proklamuar laike (largimi i bashkësive dhe i grupeve fetare nga shteti).

E drejta e shtetësisë, gjithashtu, është e drejtë personale e cila nuk mund t'i merret asnjë shtetasi të RM. Gjithashtu, shtetasi i RM nuk mund të largohet nga shteti.

¹ Amandamenti i XIX nga Kushtetuta e RM.

Të drejtat dhe liritë politike e shprehin subjektivitetin politik të qytetarit, duke i ofruar pjesëmarrje aktive në jetën politike në vend. Në teori, këto të drejta dhe liri, emërtohen si të drejta dhe liri publike dhe pozitive. Ato natyrisht bashkangjiten me të drejtat dhe liritë e shekullit XIX dhe XX në procesin e ndërtimit të pluralizmit politik dhe të demokracisë parlamentare. Të drejtat dhe liritë standarde politike janë : liritë e të folurit publik, liria e informimit; liria e shoqërimit politik, e drejta e zgjedhjes, e drejta për tubime të qeta.

Kushtetuta e RM, përveç këtyre të drejtave, e numëron edhe të drejtën e kryerjes së funksioneve publike dhe të drejtën e parashtrimit të parashtrësive.

Liria e të folurit publik dhe e paraqitjes publike do të thotë, e drejtë e njeriut publikisht t'i shprehë mendimet e veta , jo vetëm me fjalë, por edhe me mjete të tjera të shprehjes.

Liria e informimit jep një shteg të lirë nga informacionet, liria e pranimit dhe përcjelljes së informatave. Kushtetuta garanton edhe lirinë e formimit të instituteve të informimit publik, të drejtën e përgjigjes në mjetet e informimit publik, të drejtën e përmirësimit në mjetet e informimit publik, të drejtën e mbrojtjes së burimeve të informimit në mjetet e informimit publik dhe e ndalon censurën.

Liria e shoqërimit politik do të thotë e drejtë e qytetarit lirisht të formojë shoqata të qytetarëve dhe të partive politike, të hyjnë dhe të largohen nga to. Programet dhe veprimtaritë e shoqatave të qytetarëve dhe partive politike nuk mund të drejtohen kah rrenimi me dhunë i rregullimit kushtetues i Republikës dhe nga nxitja ose thirrja në agresionin ushtarak ose të nxitjes nacionale, racore ose urrejtjes fetare dhe padurueshmërisë.

E drejta e zgjedhjes në RM është e garantuar si e drejtë e barabartë, e përgjithshme dhe direkte e cila realizohet në zgjedhjet e lira me votim të fshehtë.

Në suazat e të drejtave politike është edhe *e drejta e tubimeve të qeta*. Qytetarët kanë të drejtë që të tubohen në mënyrë të qetë dhe të shprehin protestë publike pa lajmërim paraprak dhe pa leje të posaçme. Shfrytëzimi i asaj të drejte mund të jetë i kufizuar vetëm në kushte të gjendjes së jashtëzakonëshme dhe luftarake.

E drejta e kryerjes së funksioneve publike është e drejtë e cila garanton arritëshmëri të funksioneve publike deri te të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë.gjegjësisht demistifikimin e tyre.

Ndaj demistifikimeve të pushtetit publik dhe ndaj krijimit të qytetarëve sa më aktivë solli edhe *e drejta e parashtrimit të parashtrësive*. Secili qytetar ka të drejtë të parashtrojë parashtrësë deri tek organet shtetërore dhe sërbitimet e tjera publike dhe prej tyre të marrë përgjigje.

Qytetari nuk mund të thirret në përgjegjësi, po as edhe të durojë pasoja të dëmshme për qëndrimet e shprehura në parashpresa, vetëm nëse me ato bëhet vepër penale.

Të drejtat dhe liritë ekonomike. Njëpër një këtyre të drejtave shprehet statusi ekonomik dhe social i njeriut dhe qytetarit. Në garantimin e tyre ka më shumë dëshira, inspirime dhe qëllime, ndërsa më pak realizim për shkak të pafuqisë materiale, por edhe voluntarizmin shtetëror të harxhimeve. Ato i takojnë të drejtave të gjeneratës me të re të promovuara në shek. XIX si rezultat i funksionit ekonomik dhe social të shtetit. Promotorët kryesor janë : Kushtetuta e Varmait nga viti 1919, Deklarata universale për të drejtat e njeriut e vitit 1948 dhe Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore nga viti 1966. Por, mes tyre gjenden edhe disa të drejta shumë të vjetra.

Të drejtën e pronësisë për vendit e hasim qysh prej Dhijatës së vjetër nga Bibla, ndërsa , gjithashtu edhe në Romën e vjetër.

Të drejtat dhe liritë ekonomike e zbulonjë karakterin e ekonomisë në një vend, ndërsa si e drejtë e rëndësishme mes tyre është e drejta e pronës. Shumë kushtetuta nuk përmbajnë dispozita për marrëdhëniet ekonomike dhe për ato kuptojmë në mënyrë indirekte nga liritë ekonomike.

Të drejtat dhe liritë sociale të qytetarëve e shprehin statusin social të qytetarëve , por edhe funksionin social të shtetit në drejtim të amortizimit të ndryshimeve sociale, si edhe stihinë e tregut ekonomik.

Shtetin social e korrigjon jobarazia, i mbron këto kategori të qytetarëve të cilat janë në gjendje të rëndë materiale dhe promovon drejtësi sociale.

Kushtetuta e RM nga viti1991 i vërteton këto të drejta dhe liri ekonomike ; e drejta e pronës, e drejta e punës, liria e punës, e drejta e grevës, e drejta e organizimit sindikal.

Sipas Kushtetutës, prona nuk është e vërtetuar vetëm si e drejtë, por edhe si detyrim në kuptim të mirë jo vetëm në interes të pronarit, por edhe në interes të bashkësisë. Në këtë kuptim, nëse atë e kërkon interesi publik i vërtetuar me ligj, prona mund të kufizohet ose të merret, por vetëm më kompenzim material që nuk mund të jetë më i ulët nga vlera e tregut.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nuk e shfrytëzon kategorinë “prona private” as edhe, i përcakton format e pronës. Megjithatë, nëse merret parasysh tërësia e Kushtetutës, situimi i pronës në pjesën e të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht kualifikimi i tregut i sipërmarrjes së lirë si bazë e marrëdhënieve ekonomike, lirisht mund të përfundohet dhe vërtetohet se prona private është formë themelore e pronës në Republikën e Maqedonisë. As prona shtetërore as edhe ajo publike nuk janë të përcaktuara me Kushtetutën e RM. Ato implicisht i njohim me kategoritë të mirat në përdorimin e përgjithshme (rrugë, kanale publike dhe

ngjashëm). Dhe të mirat nga interesi i përgjithshëm për Republikën (pasuritë natyrore, bota bimore dhe shtazore, sende dhe objekte me rëndësi kulturore dhe historike për Republikën e Maqedonisë).

Sipas frymës dhe parimeve të ekonomisë së tregut, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë garanton të drejtën e pronës, në kushte të përcaktuara me ligj edhe personave të huaj.

Logjika e tregut është edhe logjikë e Kushtetutës, prandaj edhe ajo personave të huaj u garanton edhe të drejtat e përfituara me investimin e kapitalit, si edhe të drejtën e e mbajtjes së lirë të kapitalit dhe fitimit (neni 50, paragrafi 1).

Qëllimi i këtyre dispozitave është të nxiten investimet e huaja në Republikën e Maqedonisë.

E drejta e trashëgimisë është e drejtë të fitojë pronë private me trashëgimi, në kushte ligjore.

Liria e punës do të thotë e drejtë e qytetarit lirisht të vendosi a do të punojë ose, jo. D.m.th., ai vetë lirisht e zgjedh profesionin e tij dhe punësimin; atij në mënyrë të barabartë i janë të ofruara të gjithë vendet e punës dhe çdo funksion në shoqëri dhe në fund, është e ndaluar puna me dhunë.

E drejta e punës është e drejtë e qytetarit, të punësohet në pajtim me aftësitë e tij. Realizimi i saj vërtetohet me ligj dhe kontrata kolektive. Në fakt, kjo e drejtë do të thotë e drejtë e marrëdhënieve të punës së përkohshme dhe të përhershme, nga njëra anë, mbrojtje e garantuar gjatë punës, në anën tjetër; dhe e drejta e kompenzimit material në rast të papunësisë, nga ana e tretë.

Kushtetuta, të punësuarëve u garanton *të drejtën për fitimin përkatës*. Gjendja e papunësisë masive, vonimi disamujorësh i pagesës dhe kompenzimi i ulët material në rast të papunësimin e sjellin në pyetje realizimin e këtyre të drejtave. Gjithashtu, edhe dispozitat e punës si bazë për udhëheqjen dhe vendimin bashkë me pronën është më shumë dekor kushtetues demokratik, se sa praktikë.

E drejta e organizimit sindikal, është t'i realizojnë dhe kërkojnë të drejtat ekonomike dhe sociale. Gjithashtu mund të kufizohet edhe me ligj edhe atë në sferën e forcave të armatosura, të policisë dhe organeve të administratës (neni 37). Në sistemet politike demokratike, sindikatat janë partner i barabartë i shtetit dhe punëdhënësve.

E drejta e grevës është e drejtë e të punësuarve të protestojnë kundër kushteve në të cilat punojnë dhe shkallës së fitimit. Kufizimi i tyre është i mundur vetëm me ligj dhe në sfera të caktuara : për forcat e armatosura, policinë dhe organet e administratës (neni 38).

Kushtetuta e RM i përcakton këto të drejta sociale : e drejta e sigurimit social, e drejta e mbrojtjes sociale, e drejta e ndihmës dhe mbrojtjes së veçantë, të drejtat e veçanta sociale, e drejta e mbrojtjes shëndetësore, e drejta e vendimit të lirë për lindjen e fëmijëve dhe e drejta e mjedisit të shëndoshë jetësor.

E drejta e sigurimit social do të thotë e drejtë e jetës së përshtatshme, në kuptim të fitimit që siguron ekzistencën e denjë, shtëpi, sigurim shëndetësor, mundësi për shkollim dhe ambient të shëndoshë jetësor. Kjo e drejtë operacionalizohet me ligj dhe kontratë kolektive. Realiteti maqedon në papunësinë enorme dhe pauperacionin e qytetarëve flet për sigurimin e lënë pas dore , dhe jorealizimin social të sigurt, gjegjësisht josigurimin social.

E drejta e sigutimit social do të thotë sigurim shëndetësor, invalidor dhe penzional të vërtetuara me ligj dhe konventë kolektive (9 neni 34, paragarfi 1) dhe me të drejtë i dedikohet personave të punësuar dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

E drejtat e mbrojtjes sociale është e drejtë e kategorisë së caktuar të qytetarëve, të ndihmës gjatë papunësisë, rrogave të ulëta ose pensioneve. Përgjegjëse për këtë mbrojtje është shteti në mënyrë të caktuar me ligj dhe kontratë kolektive.

E drejta e ndihmës u dedikohet qytetarëve të paaftë dhe të pafuqishëm për punë, ndërsa e drejta e rehabilitimit i mbulon invalidët.

Të drejta të veçanta sociale posedojnë : luftëtarët nga Lufta Antifashiste dhe nga gjithë luftërat nacionalçlirimtare për Maqedoninë, invalidët e luftës; personat e ndjekur dhe të burgosurit për idetë e vetëqenies të popullit maqedon dhe qeverimit të tyre.

Të drejtat sociale të veçanta janë të miratuara për kontributin e veçantë për shtetin maqedon, por jo privilegje.

E drejta e mbrojtjes shëndetësore është e drejtë e secilit prej nesh, pa marrë parasysh statusin e punës, të marrin shërbime shëndetësore nga entet shëndetësore.

E drejta e vendosjes së lirë për lindjen e fëmijëve është e drejtë e gruas që lirisht të vendosë për lindjen.

Familja dhe mëmësia, fëmijët dhe personat e mitur, sipas Kushtetutës, gëzojnë mbrojtje të veçantë. Prindërit kanë të drejtë dhe obligim të kujdesen për edukimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve. Fëmijët, janë të obliguar të kujdesen për prindërit e tyre të moshuar.

Mbrojtje të veçantë u garantohet fëmijëve pa prindër dhe atyre pa kujdes prindorë. Nënata dhe të miturit gëzojnë mbrojtje të veçantë gjatë punës. Ndërsa personat nën 15 vjet nuk mund të punësohen.

E drejta e ambientit jetësor shëndetësor është e drejtë e ajrit dhe natyrës së pastërt, pa të cilën është e pamundur aktiviteti normal shoqëror i njerëzve. Kuptohet, secili prej nesh është i obliguar t'a mbrojë dhe përparojë ambientin jetësor. Shteti, sipas nenit 43, është i obliguar të krijojë kushte të duhura për këtë qëllim.

Të drejtat dhe liritë kulturore i ofrojnë njeriut të shprehet si person i veçantë në sfera të ndryshme, t'a vëzhgojë rrethin në të cilin jeton, të mësojë dhe t'a profesionalizojë diturinë dhe shpirtin, të veprojë.

Kushtetuta e RM nga viti 1991 i vërteton këto të drejta dhe liri kulturore ; të drejtën e arsimit, lirinë e krijimtarisë shkencore dhe artistike, lirinë e të shprehurit, përkujdesje dhe zhvillim të identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të shoqërisë.

E drejta e arsimit është e drejtë e secilit nën kushte të barabarta për marrjen e diturive në të gjitha shkallët e arsimit. Asnjë, po edhe prindërit, bashkësitë fetare ose subjektet e tjera, nuk mund t'a kufizojnë dhe ndalojnë këtë të drejtë.

Norma kushtetuese e vërteton domosdoshmërinë e arsimit fillor. Me qëllim të që fusë konkurrencë dhe afarizëm edhe në sferën e arsimit. Kushtetuta e promovon mundësinë e hapjes së instituteve private të arsimit në arsimin e mesëm dhe të lartë.

Kushtetuta , gjithashtu, e garanton autonominë e Universitetit me qëllim që të ofrojë kryerje të pavarur dhe kualitative në funksionet e tyre edukativo-arsimore dhe shkencoro-hulumtuese. Kuptohet, pa status autonom të Universitetit nuk mund të pritët sinjeritet për vizionet e reja, të vërtetat dhe provokimet shkencore.

Liria e krijimtarisë shkencore dhe artistike është e drejtë e qytetarit që lirisht të krijojë në pajtim me mendimin dhe besimin e vetë. Kuptohet, krijuesi ka të drejtë në autorësisë ndaj fryteve (krijimeve) nga krijimtaria e tyre. Krijimet e karakterit material emërtohen si pronë industriale, ndërsa ato të llojit shpirtëror si pronë intelektuale. Ato nga shteti dhe ligjet ndërkombëtar janë të mbrojtura si pasuri materiale dhe shpirtërore gjithnjëzore.

Shteti maqedon është i obliguar të kujdeset për zhvillimin e lirisë së krijimtarisë, për shkak të rëndësisë së saj për zhvillimin e kulturës.

Lirinë e të shprehurit të përkatësisë nacionale, më parë e kemi potencuar si vlerë themelore të rregullimit kushtetues në Republikën e Maqedonisë. Bëhet fjalë për njërin nga çështjet më të ndjeshme dhe më suptile, veçanërisht te shoqëritë heterogjene etnike, siç është jona. Liria e të shprehurit të përkatësisë nacionale është

metod demokratike, e kundërt me etnocentrizmin dhe asimilimin si koncepte jodemokratike në shoqëritë multietnike.

Neni 48, pjesëtarëve të bashkësive u garanton të drejtën e formimit të instituteve kulturore , artistike dhe arsimore, si edhe shoqëri të ndryshme shkencore për shkak të shprehjes, përkujdesjes dhe zhvillimit të identitetit të tyre. Gjithashtu, pjesëtarët e bashkësive kanë të drejtë të mësimin në gjuhën e tyre amëtare në arsimin fillor dhe të mesëm në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimi zhvillohet në gjuhë tjetër mësohet edhe gjuha maqedone.

4. Obligimet e njeriut dhe qytetarit

Obligimet e njeriut dhe qytetarit janë të pandashme me të drejtat dhe liritë themelore. Ato, në frymën e konceptit liberalo–demokratik, janë në mënyrë restriktive të vërtetuara.

Të drejtat e shprehin lirinë e individit dhe demokracinë, ndërsa obligimet- fuqia e shtetit dhe përgjegjësia e qytetarëve ndaj asaj.

Obligimt standarde në të drejtën kudhtetuse komparative janë : respektimi i kushtetutës dhe i ligjeve; kryerja e sinqertë e funksioneve publike; pagimi i taksave dhe tatimeve të tjera, ndihma në situata të rënda, mbrojtja e rrethit njerëzor dhe natyror; mbrojtja e vendit.

Në Kushtetutën e RM janë të numëruara edhe obligimi i prindërve të kujdesen për fëmijët, si edhe për kryerjen e shkollës fillore.

Obligimi i qytetarëve është institut juridik, më i ngushtë nga përgjegjësia si kategori juridike, por edhe politike dhe filozofike. Megjithatë, disa obligime siç janë lojaliteti ndaj shtetit, kryerja e sinqertë e funksioneve publike, kujdesi prindorë për fëmijët dhe kujdesi i secilit nga ne për tjetrin që është në fatkeqësi kanë karakter më të gjerë se ai juridik.

Shoqëria pa liri është despoti, ndërsa shoqëria pa përgjegjësi është anarki.

Demokracia është sistem politik përgjegjës.

5.Mbrojtja juridike e të drejtave dhe lirive themelore

Dallojmë dy lloje të mbrojtjeve juridike të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit : të brendshme dhe të jashtme. Mbrojtja e brendshme juridike realizohet nëpërmjet të drejtës pozitive në vend konkret, ndërsa e dyta (e jashtme) me ndihmën e të drejtës ndërkombëtare.

Ekzistojnë forma të ndryshme të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave gjyqësore si formë themelore, ombudsmani ose avokati i popullit si organ për

mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut kur ato janë të shkelura nga organet e administratës shtetërore, kontrollit parlamentar ndaj kryerjes së lirive dhe të drejtave nga ana e komisioneve dhe të trupave tjera punuese të parlamentit.

Në botë ekzistojnë mbrojtje e lirive dhe të drejtave nga ana e gjyqjeve të rregullta.

Mbrojtja ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave rrjedh nëpërmjet vëzhgimit dhe kontrollit (monitoringut), si edhe nëpërmjet sanksioneve kundër shteteve – anëtare ne OKB në rast të shkeljes me të gjerë dhe të vrazhdë të të drejtave dhe lirive.

Me Kushtetutën e RM nga viti 1991 janë të parapara format për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, p.sh. nga gjukata e rregullt, nga Gjyqi Kushtetues, nga Avokati i popullit, nga komisioni i përhershëm anketues i Kuvendit të RM.

Kushtetuta e RM nga viti 1991 parasheh të drejtën e qytetarit të jetë i njoftuar me të drejtat njerëzore dhe liritë themelore dhe aktivisht të kontribuojë, veç ose bashkërisht për përparimin dhe mbrojtjen. (neni 50,paragrafi).

Me ratifikimin e Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë u është vënë në dispozicion edhe peticioni para Gjyqjit për të drejtat njerëzore pranë Këshillit të Evropës në Strazburg, si një nga mjetet për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Me Gjyqin për të drejtat njerëzore në Strazburg mund të drejtohet secili person i cili mendon se i janë të shkelura të drejtat që i garanton Konventa Evropiane.

Kushtet procesore që duhet të plotësohen janë :

- **të jenë të shteruara të gjitha mjetet juridike në shtet;**
- **peticioni te jepet në afat prej 6 muajsh nga vendimi perfundimtar që i dedikohet gjoja shkeljes së të drejtave të Konventës.**

Përpara Gjyqjit për të drejtën njerëzore personi e padit shtetin i cili e ka shkelur ndonjë të drejtë, gjegjësisht nuk i ka siguruar mbrojtje të të drejtave nga ndonjë tjetër. Gjyqi për të drejtat njerëzore mundohet të arrijë “marrëveshje miqësore” në mes të personit i cili ankohet dhe qeverisë, por në rast se deri tek ajo nuk vjen, Gjyqi mund ta ngarkojë qeverinë materialisht t’a kompenzojë personin e drejta e të cilit është shkelur.